

08.03.2021
Ora 14:30

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në në përfundim të tyre”.


PJESËMARRJA :

KQZ:

- Ilirjan **CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana **NANO** Kryetar
- Arens **ÇELA** Anëtar
- Dritan **ÇAKA** Anëtar
- Helga **VUKAJ** Anëtar
- Muharrem **ÇAKAJ** Anëtar
- Stafi **KQZ** Y.Merkaj, M.Koja
- Parti Politike: PD(I.Kaso),LSI(A.Kaziaj),LN(E.Bushati)

Znj.I.Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator i njoftuar për sot në orën 14:00, ndjesë që u shty për pak. Në rendin e ditës, të mbledhjes së Komisionit Rregullator kemi një projektvendim: “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”. Me sa po shoh, jemi të pranishëm në mbledhjen e Komisionit Rregullator vetëm tre prej anëtarëve, që do të thotë nuk kemi kuorumin e nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen. Sipas nenit 20 të “Rregullores për Organizimin dhe

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.08.03.2021**

Funksionimin” e Komisionit Rregullator miratuar me vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator: “në rast se mungon kuorumi për zhvillimin e mbledhjes ajo shtyhet për jo më vonë se pas tre ditësh”. Pikërisht sepse jemi në një periudhë jashtë 1 muaj para datës së zgjedhjeve, pra 1 muaj para datës së zgjedhjeve shtyrja e mbledhjes lejohet deri në 12 orë, jashtë kësaj periudhë jo më vonë se pas tre ditësh. Kështu që duhet ta shtyjme mbledhjen e Komisionit Rregullator, pra seanca nuk mbyllet këtu por do të zhvillohet në një ditë tjetër. Do të njoftoheni përsëri zyrtarsisht për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



09.03.2021
Ora 17:04

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në në përfundim të tyre”.


PJESËMARRJA :

KQZ:

- Ilirjan **CELIBASHI** **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- Ilirjana **NANO** **Kryetar**
- Arens **ÇELA** **Anëtar**
- Dritan **ÇAKA** **Anëtar**
- Helga **VUKAJ** **Anëtar**
- Muharrem **ÇAKAJ** **Anëtar**
- Stafi **KQZ** **Y.Merkaj, M.Koja**
- Parti Politike: PD(I.Kaso),LSI(A.Kaziaj),LN(E.Bushati)**

Znj.I.Nano: Mirëmbërëma! Ditën e djeshme Komisioni Rregullator u mbledh por në mungesë të kuorumit mbledhja publike u shty për sot në orën 17:00. Atëhere, sot pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit Rregullator është e plotë. Kështu që fillojmë mbledhjen në rendin e ditës së mbledhjes kemi projektvendimin, shqyrtimin e projektvendimit “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”. Të pranishëm në mbledhje sikundër theksova janë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator,

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjithashtu. Janë të pranishëm dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore, të Partisë Demokratike, të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuesi dhe zëvendësuesi dhe po shoh edhe një përfaqësues nëse mund të prezantohet, i cilit subjekt zgjedhor?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Përfaqësuese e Partisë Lëvizja për Ndryshim!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Është akredituar zonja Bushati?

Z. Y. Merkaj: Po, është subjekt zgjedhor.

Znj. I. Nano: Po, faleminderit! Atëhere akti që kemi për të shqyrtuar sot, është një ndër aktet që janë në kompetencë të Komisionit Rregullator, bëhet fjalë pikërisht për Portalin e Denoncimeve lidhur me financimet e fushatës. Detyrimi për të miratuar këtë akt buron nga neni 92 fraksion 5 i Kodit Zgjedhor, paraprakisht do të ftoja Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të prezantonte aktin dhe relacionin përkatës. Por ndërkohë për procedurë më duhet të pyes anëtarët e komisionit nëse ka ndonjë çështje jashtë rendit të ditës që dëshirojnë të diskutojnë që të mund të rregjistrojë diskutimet? Në rregull, kolegët nuk kanë! Atëhere mbetemi vetëm tek çështja që kemi në rendin e ditës. Zoti Merkaj ju lutem!

Z. Y. Merkaj: Referuar neni 92/5 të ligjit nr.10019, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve krijon dhe mirëmban portalin në internet, me akses të lirë, për të denoncuar prej kujtdo shkeljet e mundshme të këtij ligji nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët në lidhje me financimin e

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

fushatës zgjedhore. Në pikën 2 të këtij neni parashikohet se kriteret dhe procedurat e hollësishme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e portalit, procedurat e hetimit administrativ dhe afatet e tij, si dhe konkluzionet që duhet të arrihen në përfundim të tij përcaktohen me akt normativ të KQZ-së. Projektakti është i përbërë nga 5 krerë dhe 18 nene. Kreu i parë ka në përmbajtje të tij 4 nene, në të cilët përcaktohen, objekti, përkufizimet, parimet dhe veprimtaria administrative hetimore e Komisionerit në shqyrtimin e këtyre denoncimeve. Kreu i dytë ka në përmbajtjen e tij, dy nene të cilët lidhen me portalin dhe formatin e denoncimeve. Referuar nenit 5 të projektvendimit, KQZ nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve krijon, administron dhe mirëmban Portalin e Denoncimeve i cili është gjithashtu pjesë e faqes së internetit të KQZ-së, lirisht dhe i aksesueshëm nga publiku. Kreu i tretë ka në përmbajtje 6 nene, në të cilët përshkruhet në mënyrë të detajuar e gjithë procedura e hetimit administrativ e kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për denoncimet, që nga momenti i depozitimit të tyre dhe deri në përfundimin e tij. Në nenin 8 përcaktohen rastet kur gjatë verifikimit paraprakë konstatohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk është organi kompetent dhe/ose mungojnë indiciet e besueshme për të nisur hetimin administrative. Nenet 9, 10, 11 dhe 12 përcaktojnë respektivisht mjetet e kërkimit të provave, metodat për paraqitjen e informacionit dhe provave, ku Komisioneri njofton me shkrim subjektin që i nënshtrohet hetimit administrativ të paraqesë informacion, të dhëna ose prova brenda 10(dhjetë) ditësh nga marrja e kërkesës dhe caktimin e ekspertëve në hetimin administrativ. Kreu i katërt trajton përfundimin e hetimit administrativ, përgatitjen e relacionit dhe procedurën e ndjekur dhe marrjen e vendimit nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kreu i pestë trajton konfidencialitetin dhe ruajtjen e anonimatit gjatë procedurave të hetimit administrativ, mbrojtjen e të dhënave personale dhe hyrjen në fuqi të projektvendimit. Ky projektvendim sjell një risi për mënyrën e veprimit dhe

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

sjelljes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si një organ që heton proaktivisht denoncimet ndaj subjekteve zgjedhore, partive politike dhe organeve të administratës publike për përdorimin e fondeve publike dhe burimeve shtetërore. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Zoti Merkaj faleminderit! Të nderuar kolegë, të nderuar përfaqësues të subjekteve zgjedhore, më lejoni të çel diskutimin në parim lidhur me projektvendimin, sipas rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator, rrada së pari u takon në diskutimet në parim anëtarëve të Komisionit Rregullator pastaj edhe përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Të nderuar kolegë keni diçka në parim? Nuk ka! Përfaqësuesit e partive, po zoti Kaziaj?

Z.A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk kemi gjë e nderuar!

Znj. I. Nano: Po, faleminderit! Atëhere, duke qenë se nuk kemi diskutime në parim lidhur me projektvendimin, le të kalojmë në votimin në parim! Të nderuar kolegë kush është dakord në parim me projektvendimin: “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbatjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Miratohet në parim!

Atëhere, kaloj në leximin të çdo neni të projektvendimit, sipas rregullores në diskutimin nen për nen së pari ju jepet fjala përfaqësuesve të subjekteve

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

zgjedhore dhe më tej anëtarëve të rregullatorit. Kështu që do t'iu lutesha përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore nëse do të kenë diçka konkretisht në një nen të caktuar të kërkojnë të marrin fjalën që të mos iu pyes pas çdo neni. Atëhere, në mbështetje të neneve 20 pika 1 shkronja f, dhe 92/5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi Kreu I, dispozita të përgjithshme: Neni 1 objekti: Objekti i këtij vendimi është:

- a) përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për funksionimin dhe mirëmbajtjen e portalit të denoncimeve nga KQZ për shkelje të mundshme për financimin e partive politike, subjekteve zgjedhore apo kandidatët e tyre dhe/ose keqpërdorim të burimeve publike në mbështetje të tyre, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dispozitat e ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, dhe/ose aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tyre;
- b) përcaktimi i procedurave dhe afateve për hetimin administrativ të këtyre denoncimeve;
- c) përcaktimi i procedurave dhe afateve për marrjen e vendimit në përfundim të hetimit administrativ të denoncimeve.

Kolegët, pyetje, diskutime keni? Nuk ka! Kalojmë në votimin e nenit 1 ju lutem me qenëse nuk ka propozime për ndryshime apo shtesa?

Kush është dakord me nenin 1 të projektvendimit të titulluar "Objekti", sipas propozimit të ardhur nga Komisioneri, të nderuar kolegë?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Miratohet neni 1!

Neni 2, përkufizime. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

***Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI***




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

1. “Denoncim” është njoftimi apo kallëzimi i kryer nga çdo denoncues në Portalin e Denoncimeve pranë KQZ-së ose drejtpërdrejt në KQZ për shkelje të mundshme për financimin e partive politike, subjekteve zgjedhore apo kandidatët e tyre dhe/ose keqpërdorim të burimeve publike në mbështetje të tyre, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, dispozitat e ligjit “Për partitë politike” dhe/ose aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tyre, për të cilat kërkon t’i nënshtrohen hetimit administrativ prej Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. “Denoncues” është çdo shtetas, person fizik ose person juridik.
3. “Komisioner” është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
4. “Portali i Denoncimeve” është faqja zyrtare elektronike e KQZ-së nëpërmjet së cilës mundësohet paraqitja e denoncimit.

Po zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: Atëhere, në pikën 1, domethënë në vijim të fjalisë “ose drejtpërdrejt në institucionin e KQZ-së, për shkelje të mundshme”, unë propozoj që të shtohen fjalët që kanë të bëjnë me dy pika (:) dy fushat kryesore që kemi parashikuar në objektin e këtij projektakti që janë konkretisht: 1. “Financimi i partive politike, subjekteve zgjedhore apo kandidatëve të tyre”. 2. “Apo keqpërdorimin e burimeve publike në mbështetje të tyre të ndahen në dy nën pika . Pra propozimi konkret që kanë të bëjnë me dy pika (:), “I”, “a”, “b” ose “ii”, si të doni. Pika e parë të jetë: “Financimin e partive politike , subjekteve zgjedhore apo kandidatët e tyre”. Pika e dytë të jetë: “Keqpërdorim të burimeve publike në mbështetje të tyre, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, dispozitat e ligjit për partitë politike dhe/ose aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tyre”.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. I. Nano: Pra propozimi juaj zoti Çakaj është thjesht për ta ristrukturur duke shtuar edhe fjalën “që kanë të bëjnë me” pas togfjalëshit “shkelje të mundshme” në pikën 1 të nenit 2.

Z.M.Çakaj: Po e nderuar!

Znj. I. Nano: Atëhere, ka propozim tjetër për nenin 2? Nuk ka! Kalojmë në votim! Atëhere, votojmë propozimin e zotit Çakaj, i cili propozoi: “ Në pikën 1, pas togfjalëshit “shkelje të mundshme” të shtohet “që kanë të bëjnë me dy pika (:)” dhe pika a:“Financimin e partive politike, subjekteve zgjedhore apo kandidatët e tyre”, gjuhësisht do të thoja apo “kandidatëve të tyre”, b:“Keqpërdorimin e burimeve publike në mbështetje të tyre në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, dispozitat e ligjit për partitë politike dhe/ose aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tyre”. Ju ftoj të votojmë propozimin e zotit Çakaj!

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Miratohet neni 2 me ndryshimin e propozuar nga zoti Çakaj!

Kalojmë tek neni 3! I titulluar: “ Parimet e veprimtarisë së Komisionerit”. Parimet bazë mbi të cilat mbështetet dhe ushtron veprimtarinë Komisioneri, sipas këtij vendimi, janë:

- a) parimi i ligjshmërisë;
- b) parimi i mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë;
- c) parimi i drejtësisë dhe paanësisë;
- ç) parimi i profesionalizmit, eficiencës dhe efikasitetit;
- d) parimi i objektivitetit dhe i marrjes së vendimeve.

Po zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. H. Vukaj: Në funksion dhe në përputhje me përmbatjen e parimeve të Kodit të Procedurës Administrative dhe duke qenë që organi publik në këtë rast Komisioneri, do të kryej një procedim administrativ dhe më tej hetim administrativ për rritjen e garancisë së veprimtarisë së tij. Meqenëse është tagër absolute e këtij organi dhe jo e administratës në këtë rast duhet të autorizojmë dhe të fusim në rradhën e parimeve edhe “parimin e përgjegjësisë” pasi është një parim i cili shkon krahasi me “parimin e ligjshmërisë” dhe i jep garanci gjithë procesit. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Atëhere, propozimi juaj është që të shtojmë “parimin e përgjegjësisë” pas gërmes “d”?

Znj. H. Vukaj: Në fakt para gërmës së fundit që i takon të jetë gërma “d” dhe gërma e fundit bëhet gërma “dh” sepse i bie që është përpara vendimmarrjes. Pra, përpara “parimit të objektivitetit dhe marrjes së vendimeve”.

Znj. I. Nano: Pra, propozimi i zonjës Vukaj është: “ Pas gërmes “ç” të shtohet gërma “d” parimi i përgjegjësisë dhe gërma “d” të kaloj si gërmë “dh” gërma pasardhëse”. Të nderuar kolegë, po zonja Bushati ju lutem! Ju lutem mikrofonin.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Së pari kështu, për një saktësim të vogël, se më kaloi, ngaqë mendova se do ta kishit lexuar. Tek neni 2 “denoncues është çdo shtetas person fizik ose person juridik” nga pikëpamja formale juridike nuk shkon, shtetas dhe person fizik se kjo është e njëjta gjë domethënë. Prandaj mendoj që për saktësim “denoncues është çdo person fizik apo juridik”. E para kjo, një gjë e thjeshtë. Ndërsa për sa i përket parimeve

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

mendoj përderisa bëjmë fjalë për veprimtarinë e Komisionerit në vijim të asaj çfarë tha zonja Vukaj, mendoj që “parimi i përgjegjësisë shoqërohet” edhe me “parimin e transparencës” se janë të lidhura llogaridhënia e transparenca e tjerë, tani këtu sigurisht nuk do rreshtojmë të gjithë parimet e Kodit të Procedurës Administrative, por për e transparencës mendoj se duhet vënë.

Znj. I. Nano: Atëhere, zonja Bushati propozimi juaj konkret?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Është që ose bashkërisht, ose në ndonjë pikë më vetë të shtohet “parimi i përgjegjësisë dhe i transparencës”.

Znj. I. Nano: Atëhere, të nderuar kolegë kemi dy propozime. Kemi propozimin e zonjës Vukaj, për të “shtuar parimin e përgjegjësisë” pas pikës “ç” dhe propozimin e zonjës Bushati përfaqësuese e një subjekti zgjedhor për të shtuar “parimi i përgjegjësisë dhe i transparencës”. Zonja Vukaj ju që bëtë propozimin e parë, i qëndroni propozimit tuaj vetëm për “parimin e përgjegjësisë”?

Znj. H. Vukaj: Mendoj që për sa kohë garancia është tek “parimi i ligjshmërisë” dhe i shtuam këto lloj garancie edhe tek “parimi i përgjegjësisë”. Meqenëse përmbatja dikton edhe ndeshjen me anonimat, pra me subjektin anonim, kjo nuk do të thotë që i mohohet gjithëkujt që të kërkoj informacion për aq sa i lejohet, por e shoh që është e ezauruar por edhe po ta shtojmë nuk është ndonjë...

Znj. I. Nano: Atëhere, votojmë propozimin e zonjës Vukaj, për të shtuar pas pikës “ç” “parimin e përgjegjësisë” dhe për të kaluar në një rradhë më poshtë “parimin e objektivitetit dhe marrjes së vendimeve”.

Kush është dakord me këtë propozim e zonjës Vukaj?

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Miratohet propozimi i zonjës Vukaj!

Votojmë ju lutem propozimin e zonjës Bushati për shtimin e “parimit të transparencës”.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: S'ka!

Kundra: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Nuk Miratohet!

Atëhere, të miratojmë në tërësi “nenin 3”, për shkak se votuam dy propozime.

Miratojmë në tërësi “nenin 3” me një propozim të miratuar tashmë.

Kush është dakord ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Miratohet neni 3!

Kalojmë tek neni 4! Veprimtaria administrative hetimore e Komisionerit.


1.Komisioneri për hetimin administrativ të denoncimeve zbaton parashikimet e bëra në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe në këtë vendim.

2.Komisioneri heton të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

3.Komisioneri përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.

4.Dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht “po e shtoj unë sepse gramatikisht mungon një lidhës administrohen kryesisht “nga” Komisioneri”, ju lutem administratës, gjatë zbardhjes ta ketë parasysh. Pra, po rilexoj edhe njëher pikën 4 të nenit 4. Dokumentet që vërtetojnë akte, fakte,

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga Komisioneri kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Komisioneri mund t'i kërkojë denoncuesit të dhëna plotësuese vetëm elementet e nevojshme për identifikimin e tyre.

5.Për faktet apo të dhëna të bëra publikisht, të siguruar nga monitoruesit e KQZ-së ose të marra gjatë kryerjes së funksionit kontrollues administrativ të KQZ-së, Komisioneri ka të drejtë të nisë hetimin administrativ ex officio, sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në këtë vendim. Atëhere, çelim diskutimin për këtë nen! Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Atëhere, po në referim të Kodit të Procedurave Administrative e gjej më vend që në pikën 2 dhe në pikën 5 të shtojmë shprehjen “kryesisht” ashtu siç mund të mendonim që do të transpozohet edhe norma. Pra, neni 77 si referencë i Kodit të Procedurës Administrative parashikon dhe ka të autorizuar “titullin parimi i hetimit kryesisht” dhe meqenëse Komisioneri si atributari kryesor ushtron këtë tagër. Atëhere, mendoj që pas fjalës heton të shtohet fjala “kryesisht” ashtu siç parashikohet në nenin 77.

Znj. I. Nano: Pra në pikën 2, “Komisioneri heton kryesisht”. Po në pikën 5?

Znj.H.Vukaj: Të zevendësohet “ex officio” më fjalën shqip “kryesisht” sepse kodi parashikon fjalën “kryesisht”.

Znj. I. Nano: Dakord! Propozim tjetër kemi? Po zonja Bushati!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Tani mendoj që tek neni 4 pika 2, kur thuhet Komisioneri heton kryesisht të gjitha faktet, kryesisht do të thotë që vihet në lëvizje vetë dhe në një farë mënyrë përjashton nëse ka ndonjë ankim apo kërkesë apo qoftë edhe denoncim, pra literalisht si të thuash ka një problem, ndërsa ajo që unë pata vështirësi për ta interpretuar vetë është tek pika 4, fjalia e parë që thotë: Dokumente që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga Komisioneri, dakord kur janë në administrim të tij, apo të organeve të tjera publike, këtë pjesën apo të organeve të tjera publike, të paktën në këtë mënyrë si është e formuluar fjalia nuk më duket e saktë!

Znj.I.Nano: Znj.Bushati faleminderit! Atëherë duke qenë se sot është mbledhja e parë ku ju përfaqësoni një subjekt zgjedhor, më lejoni vetëm diçka, sa i përket rregullores,organizimit dhe funksionimit të Komisionit Rregullator, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, në këtë fazë të shqyrtimit të aktit, kanë të drejtë të bëjnë propozime konkrete për shtesa apo ndryshime.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Po sigurisht, por,

Znj.I.Nano: Do t'ju ftoja në këtë rast apo një rast tjetër ta materializonit komentit tuaj me një propozim konkret, tjetra lidhur apo thjesht ndoshta në emër të kolegëve, znj.Vukaj në momentin që bëri propozimin, theksoi referencën në nenin 77 të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me hetimin kryesisht, pra nuk bëhet fjalë për fillimin kryesisht të procedurës, por bëhet fjalë për hetimin kryesisht nga ana e Komisionerit, për koment kjo por nëse ju keni një propozim konkret për shtesë apo ndryshim në nenin 4, ju lutem, para se të kalojmë në votim,

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Mendoj që mënyra sesi është hartuar fjalia, pra po ta marrësh në një interpretim, administrohen kryesisht nga Komisioneri kur janë në administrim të tij apo administrohen nga organet e tjera publike, kështu kuptohet dhe unë e shoh, domethënë për të bërë propozimin duhet të kuptoj qëllimin e atj që e ka formuluar,

Z.M.Çakaj: Shiko, atëhere nëse,

Znj.I.Nano: Z.Çakaj, po jo nuk duhet ta sqarojmë në çdo rast,


Z.M.Çakaj: Nëse më lejon,

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Ne e lëmë se kjo është për teknikalitet, por mendova cilat...

Znj.I.Nano: Do të na ndihmonit shumë nëse do të kishit një riformulim të propozuar zyrtarisht që ne ta votojmë. Po z.Çakaj?

Z.M.Çakaj: Atëhere për sqarim, mënyra sesi është formuluar pika 4 e nenit 3, ka të bëjë me rastin kur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve e ka administruar denoncimin dhe e ka filluar procedurën kryesisht të hetimit dhe në funksion të hetimit administrativ, ai ka të drejtë të administrojë të gjithë atë dokumentacion akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të cilat i shërbejnë atij për zhvillimin e kësaj procedure të hetimit administrativ dhe këto akte, fakte apo dokumentacion apo cilësi, mund të jenë në administrim të tij, ose mund të jenë në administrim të organeve të tjera dhe në këtë rast, Komisioneri, biles këtu do të sugjeroja, do të propozoja unë konkretisht që për thjeshtësi dhe në vijim të kuptimit të kësaj fjalie,

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

fjalë e fundit pra gjithë sa thamë më sipër do të bëhet; Komisioneri mund t'i kërkojë denoncuesit vetëm elementët e nevojshëm për identifikimin e tyre dhe e thjeshton gjithë kuptimin e këtij neni. Kështu që, besoj kjo është,

Znj.I.Nano: Unë mendoj që kjo nuk ka lidhje, fjalë e dytë me të parën është tjetër gjë, gjithë dokumentet, fakte, cilësi, gjendje juridike çfarë i duhet Komisionerit ato që i administron vetë dhe ato që mund t'i kërkojë nga organet e tjera.

Z.M.Çakaj: Po po ky është kuptimi,

Znj.I.Nano: Pra kjo nuk ka lidhje, fjalë e dytë është çfarë mund t'i kërkojë përtej asaj që ka dërguar në momentin e denoncimit.

Z.M.Çakaj: Ishte në kuptimin gramatikor, pra Komisioneri mund t'i kërkojë denoncuesi vetëm elementët e nevojshëm për identifikimin.,

Znj.I.Nano: Janë të dhëna.

Z.M.Çakaj: Po të dhëna.

Znj.I.Nano: Kështu që, le të votojmë, në këtë moment kemi propozimin e znj.Vukaj, për të shtuar në pikën 2 të nenit 4, pas fjalës Komisioneri heton të shtohet fjala kryesisht dhe në pikën 5 nenit 4 fjala "ex officio" të zëvendësohet me kryesisht. Ju ftoj kolegë të votojmë këtë propozim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 4 i projekvendimit!


Kalojmë në kreun 2. Portali dhe formati i denoncimeve. Neni 5, portali i denoncimeve.

- 1.KQZ-ja nën autoritetin portali i denoncimeve dhe përgjegjësinë e Komisionerit krijon, administron dhe mirëmban portalin e denoncimeve.
2. Portali i denoncimeve është pjesë e faqes së internetit të KQZ-së dhe duhet të jetë e aksesueshme lirisht nga publiku.
- 3.Komisioneri kujdeset që portali i denoncimeve plotëson kërkesat e mëposhtme të cilësisë: a.të përdoret lehtësisht, b. aksesohet nëpërmjet pajisjeve të ndryshme të komunikimit elektronik, gramatikusht duhet hequr ajo e-ja, c jo ç, për administratën ju lutem dhe për zyrtarin që mban shënimet. c.Plotëson kërkesat e mëposhtme të aksesueshmërisë, perceptueshmërisë, operueshmërisë, kuptueshmërisë dhe qendrueshmërisë. Po znj.Vukaj?

Znj.H.Vukaj: Znj.Nano, këtu për hir të asaj që teknologjia kërkon në ditët e sotme dhe një faqe e rëndësishme siç është portali i denoncimeve, propozoj që të shtohet në fund të pikës c edhe siguria e cila si materializim ka mos hakerimin në një farë mënyre, por duke qenë se mos hakerimi nuk është një term shqip, atëherë të shtojmë termin sigurisë”, mbas qendrueshmërisë, sigurisë.

Znj.I.Nano: Qendrueshmëria, siguria. Pra, edhe njëherë janë perceptueshmëria, operueshmëria, kuptueshmëria dhe presje qëndrueshmëria dhe siguria është propozimi juaj. Propozim tjetër? Atëhere ftoj të votojmë propozimin e znj.Vukaj për të shtuar edhe një nga kërkesat që është siguria, pra fjalën dhe siguria, në gërmën, shkronjën c të pikës 3, të nenit 5, Ju ftoj ta votojmë nenin 5 me propozimin, ose të votojmë propozimin e znj.Vukaj?

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 5 me propozimin e zgj.Vukaj!

Neni 6, formati i denoncimit.

1.Formati i denoncimit është sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe mund të plotësohet nëpërmjet portalit të denoncimeve osë të dërgohet në KQZ në formë të shkruar.

2.Denoncimi mund të shoqërohet me të dhëna, dokumente, video, foto apo informacione të tjera, që sipas denoncuesit mund të vërtetojnë pretendimet në denoncimin e paraqitur prej tij, ato mund të ngarkohen elektronikisht në portalin e denoncimeve ose të dërgohen elektronikisht apo fizikisht në KQZ.

3.Në përmbajtje të denoncimit duhet të vendoset detyrimisht informacioni në lidhje me: a.Të dhëna që shërbejnë në lidhje me identifikimin e denoncuesit dhe adresën e tij, b.Objektin e denoncimit dhe një përshkrim të shkurtër për denoncimin e bërë sipas këtij vendimi, c.Aktin ligjor ose nënligjor të shkelur nëse është e mundur ta përcaktojnë.

4.Denoncuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim, por denoncimi i tij të pranohet për shqyrtim vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit si dhe informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme. Dakord, për nenin 6, çelim diskutimin? Nëse nuk ka diskutime, atëherë ju ftoj të votojmë nenin 6 sipas përmbjatjes së propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Të nderuar kolegë,

Kush është dakord me nenin 6?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 6!

Kalojmë në kreun 3, hetimi administrativ i denoncimeve. Neni 7, nisja dhe afati i procedurës administrative. Komisioneri fillon procedurën administrative, mendoj që ka një gabim, po e lexoj kështu siç e mendoj unë fjalinë gabim gramatikor gjithmonë. Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ me depozitimin e denoncimit në portalin e denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtëpërdrejtë në KQZ. Pika 2 si rregull afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë nga paraqitja e tij. 3. Afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit kur çështja është komplekse ose kur është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë. Çelim diskutimet për këtë nen. Po z.Çakaj? Po znj.Bushati?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Pika 2, mendoj që afati 60 ditor është shumë për çështjen e zgjedhjeve, kështu që mendoj të jetë më i shkurtër të jetë 15 ditor, propozoj, ose të paktën nëqoftëse ka një argumentim pse nuk duhet të jetë 15 ose 20 ditor a diçka e tillë të thuhet, por 60 ditë është shumë për të trajtuar denoncimin në periudhë zgjedhore.

Znj.I.Nano: Atëhere, e para është jo më e gjatë se 60 ditë, e dyta meqë kemi strukturën juridike, sekretarin e përgjithshëm do ti lutesha të na sqaronin si e kanë menduar, ku janë bazuar znj.Koja?

Znj.M.Koja: Po përshëndetje! Afati 60 ditor është afati i përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe siç ju e theksuat jo pa qëllim pika 2 e nenit 7

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

është perifrazuar jo më i gjatë se 60 ditë, Çka do të thotë parimi i efijencës sa më parë të jetë e mundur do të funksionojë dhe në këtë rast. Faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit znj.Koja, po z.Çakaj?


Z.M.Çakaj: Atëhere unë kisha 2 propozimë në nenin 7, konkretisht në pikën 1 sigurisht dhe unë bashkohem me juve në konstatimin tuaj për sqarim gramatikor të fjalisë së parë dhe propozoj konkretisht, Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetim administrativ kryesisht, pra propozoj të shtohet fjala kryesisht pas, po, pas fjalës administrativ dhe...

Znj.I.Nano: Dakord.

Z.M.Çakaj: Dhe së dyti gjithmonë referuar Kodit të Procedurave Administrative, bie dakord me formulimin e pikës 2, të nenit 7 se afati është jo më i gjatë se 60 ditë, por propozoj që të hiqet fjala si rregull, sepse përcaktimi si rregull nëse e lëmë në këtë nen, atëhere automatikisht mund të krijojë premisa të tejkalohet dhe ky afat, kështu që afati, pra pika e dytë riformulohet dhe të fillojë afati që ka KQZ-ja, për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë nga paraqitja e tij. Sigurisht vlen të theksojmë se natyra e denoncimeve dhe natyra e hetimit administrativ për këto raste kërkon një proces kompleks hetimi administrativ, marrje të provave dhe besoj ky proces të jetë sa më i plotë dhe sa më gjithëpërfshirës do kërkojë kohën e duhur, kështu që besoj,

Znj.I.Nano: Dakord, z.Çakaj, faleminderit! Atëhere kemi 2 propozime nga ju për të shtuar fjalën kryesisht në pikën 1, pas hetimit administrativ, kemi propozimin e dytë të hiqni fjalën si rregull dhe kemi propozimin e znj.Bushati për ta lënë

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

afatin jo më të gjatë se 15 ditë. Znj.Bushati pas sqarimit nga Drejtoria Juridike, i qëndroni propozimit tuaj për ta hedhur në votim?


Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Unë bëra një arsyetim që them se 60 ditë për sa ka objekt ky akt, tejkalon, humbet dhe kuptimin e denoncimit, çfarë kuptimi ka një vendim i Komisionerit i marrë më 20 qershor, kur zgjedhjet janë më 25 prill. Pra ky është sensi im por unë e di që afatet në Kodin e Procedurave Administrative janë ato që janë, faki që është thënë jo më i gjatë, kjo i lë lirinë dhe diskrecionit organit që të mbrohet, ta mbrojë vendimarrjen me këtë afat. Ky është mendimi im. Ndërsa përsa i përket atë që propozoi z.Çakaj, nëse hiqet fjala si rregull atëhere automatikisht, duhet të ketë një rregullim edhe për pikën 3, pra nëqoftëse vendosim që rregulli është ky dhe pastaj thuhet që ky rregull mund të zgjatet me pikën 3, kur janë komplekse atëhere këto bien ndesh me njëra tjetrën. Mendoj, nëqoftëse hiqet fjala si rregull.

Znj.I.Nano: Atëherë, znj.Bushati më duket se jam e detyruar edhe njëherë të sqaroj diçka, të lutem

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Jo, unë nuk jam aq...

Znj.I.Nano: Jo të lutem a mundem, meqënëse e fillova fjalinë. Më duhet të sqaroj edhe njëherë rolin dhe pozitën që kanë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në mbledhjen e Komisionit Rregullator. Pra sipas rregullores sigurisht që komentet lidhur me propozimet e anëtarëve të Komisionit i takojnë anëtarëve të Komisionit dhe përtej kësaj i takojnë edhe me votë anëtarëve të Komisionit, kështu që në rastin tuaj si përfaqësues të subjekteve zgjedhore do tu lutesha të mos ta kthejmë thjesht në një tryezë diskutimi, është një mbledhje ku ju keni një pozicion të

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*


kaktuar, ju buron nga ligji, ju buron nga rregullorja dhe në rregulloren tonë keni ato momente ku mund të ndërhyini dhe për çfarë duhet të ndërhyini. Kështu që ju lutem juve dhe përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore të tjera të rezervoheshit në komente për propozime ndaj anëtarëve të Komisionit Rregullator. Kështu që më lejoni tju pyes edhe njëherë, para se të kaloj në votim, i qëndroni propozimit tuaj që në pikën 2, afati jo më i gjatë se 60 ditë, të jetë jo më i gjatë se 15 ditë. Dakord. Atëherë filloj me rradhë votimin e propozimeve.

Znj.H.Vukaj: Të lutem para se të kalojmë në votim...

Znj.I.Nano: Po znj.Vukaj, po!

Znj.H.Vukaj: Një sqarim të vogël, ndoshta me të drejtë znj.Bushati bëri këtë ndërhyrje dhe ka merakun e zgjatjes së një afati të cilin jemi të detyruar ta respektojmë Kodin dhe ta shohim apo ti referohemi Kodit që thotë jo më shumë se 60 ditë. Pra është marzhi përfundimtar, pra marzhi tavan, por të mos harrojmë që në nenin 4 sapo miratuam, që Komisioneri për hetimin i referohet Kodit të Procedurave Administrative, që do të thotë ky merak i këtij efekti që mund të japi një financim i paligjshëm apo një ndikim i paligjshëm, ezaurohet nga një Komisioner tejet i përgjegjshëm i cili mund ti referohet shumë mirë nenit 91 ku thuhet: Afati për përfundimin e procedurës administrative dhe thuhet: 1.Procedura administrative e nisur me kërkesë me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm. Pra kemi të gjithë mundësinë që ai ta zhvillojë këtë procedim me ndikim në interesin publik apo në të mirat publike brenda kuadrit të nenit 91, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj.I.Nano: Znj.Vukaj, faleminderit! Atëherë unë kaloj në votim. Kemi 3 propozime për ndërhyrje në nenin 7. Propozimi i parë, propozimi i z.Çakaj, në pikën 1 pas togfjalëshit hetimin administrativ, të shtohet fjala kryesisht. Votojmë ju lutem këtë propozim?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Propozimi i dytë është gjithashtu i z.Çakaj, për të hequr togfjalëshin si rregull nga pika 2 e nenit 7.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Propozimi i tretë është propozimi i znj.Bushati përfaqësuese e subjektit zgjedhor, ndjesë znj.Bushati edhe njëherë ju lutem emrin e subjektit tuaj?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: LN, Lëvizja për Ndryshim.

Znj.I.Nano: Lëvizja për Ndryshim. Propozimi i znj.Bushati është afati 60 ditë të jetë 15, pra jo më i gjatë se 15 ditë nga paraqitja e saj/ e tij. Ju lutem votojmë të nderuar kolegë,


Kush është pro propozimit të znj.Bushati?

Pro: Asnjë!

Kundra: (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Me 5 vota kundër nuk miratohet propozimi!

*Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Di.09.03.2021*

Për shkak se kemi hedhur në votim 3 propozime, 2 prej të cilave janë miratuar, 1 jo, do të lutesha kolegët të votojmë në tërësi nenin 7, me 2 ndryshimet e propozuara dhe të miratuara tashmë. Edhe njëherë kolegë për nenin 7.

Kush është dakord në tërësi?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, neni 7 u miratua me 2 ndryshimet e propozuara nga z.Çakaj dhe të votuara me unanimitet nga Komisioni Rregullator!

Neni 8. Veprimet paraprake administrative për denoncimin.

1.Komisioneri nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, brenda 5 ditësh nga paraqitja e denoncimit; a.Verifikon kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e tij. b.Verifikon nëse përcaktohet qartë shkelja dhe nëse ka indicie të besueshme për të filluar hetimin administrativ.

***Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. I. Nano: 2. Në rastet kur KQZ nuk është organi kompetent dhe/ose mungojnë të dhënat e besueshme për të nisur hetimin administrativ, Sekretari Përgjithshëm i KQZ-së i propozon në mënyrë të arsyetuar Komisionerit për të vendosur refuzimin për nisjen e hetimit administrativ. Vendimi i Komisionerit i njoftohet denoncuesit dhe subjektit ndaj të cilit është bërë denoncimi si rregull brenda pesë ditëve. Në çdo rast Komisioneri mund të vendos të filloj hetimin administrativ.

3. Në rast se pas verifikimit sipas pikës 1 të këtij Neni konsiderohet se ka të dhëna të besueshme që mund të tregojnë shkelje për financimin e partive politike, subjekteve zgjedhore apo kandidatët e tyre dhe/ose keqpërdorim të burimeve publike në mbështetje të tyre, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, dispozitat e ligjit për partitë politike dhe/ose aktet ligjore të miratuara për zbatimin e tyre Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së i propozon në mënyrë të arsyetuar Komisionerit fillimin e hetimit administrativ.

Fillojmë diskutimin për këtë nen.

Atëherë, po iu drejtohëm përfaqësueseve të subjekteve zgjedhore nëse kanë propozim konkret për shtesa/ndryshime.

Nuk ka, atëherë nga anëtarët e Rregullatorit ka propozime konkrete?

Po, znj. Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Atëherë, duke iu referuar Kodit dhe siç më sipër recitua ky është një tagër dhe kompetencë e drejtpërdrejtë dhe njëkohësisht përgjegjësi e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në këtë kuadër mendoj që në të gjitha pikat ka nevojë për ndërhyrje ku ky rol t'i adresohet drejtpërsëdrejti Komisionerit dhe më pas ai me një akt individual mund ta delegoj në respektim të Kodit të Procedurave Administrative.

Ndërhyrje kërkohet në pikën 1, konkretisht ku duhet të bie sipas mendimit tim ose mund ta konsideroj propozim fjala "Sekretar i Përgjithshëm" dhe fjalia

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

mund të jetë “Komisioneri brenda pesë ditësh nga paraqitja e denoncimit..” dhe kjo lidhet me Parimin e Përgjegjësisë.

Në pikën 2 ku sërish duhet të bie vazhdimi i fjalisë “Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së i propozon në mënyrë të arsyetuar Komisionerit ..” dhe fjalia të plotësohet me “Komisioneri vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ..”.

Në pikën 3 në fund të fjalisë pas fjalës “..për zbatimin e tyre” të shtojmë “Komisioneri merr vendim për fillimin e hetimit administrativ.”, faleminderit!

Znj. I. Nano: Për këtë propozim të znj. Vukaj, ju lutem sepse është në fakt një propozim për ndërhyrje të rëndësishme.

Unë e vlerësoj në fakt shumë të rëndësishme referuar edhe Parimit të Përgjegjësisë që e miratuar më sipër, gjithashtu me propozimin e zonjës Vukaj. Faktin që ky përgjegjësi i ngarkohet Komisionerit. Pastaj në çfarë mënyrë Komisioneri ndërmerr gjithë veprimin paraprak deri në vendimmarrjen e tij është një gjë që e vlerëson ai. Mund të ngarkoj një person, një strukturë ose mund të këtë një strukturë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që merret me hetimin. Personalisht e vlerësoj propozimin e zonjës Vukaj. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë koment para se të kalojmë në votim?

Atëherë, propozimi i zonjës Vukaj konsiston në:

1. Në pikën 1 të hiqet shprehja “nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së”
2. Në pikën 2 shprehja “Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së i propozon në mënyrë të arsyetuar Komisionerit për të vendosur refuzimin për nisjen e hetimit administrativ” të zëvendësohet me “Komisioneri vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ.”
3. Në pikën 3 shprehja “Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së i propozon në mënyrë të arsyetuar Komisionerit fillim e hetimit administrativ” të zëvendësohet me shprehjen “Komisioneri merr vendim për fillimin e hetimit administrativ”.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALHTARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. Vukaj isha e saktë me propozimet tuaja?

Znj. Vukaj: Po, e saktë ishit.

Znj. I. Nano: Kolegë duke qenë se bëhet fjalë për të njëjtin parim, pra kalimin nëpërmjet parimit të sigurisë..

Znj. Vukaj: Përgjegjësisë..

Znj. I. Nano: ..dhe të përgjegjësisë nga Sekretari i Përgjithshëm siç është propozuar në akt tek Komisioneri më lejoni t'i votojmë një nga një më mirë dhe jo të tria bashkë edhe pse është në parim e njëjta gjë, por shprehjet, togfjalëshat janë të ndryshëm.

Votojmë propozimin e zonjës Vukaj për heqjen e shprehjes “nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së” nga pika 1 e Nenit 8.

Kush është dakord, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Në pikën 2 propozohet të hiqet shprehja “Sekretari Përgjithshëm i KQZ-së i propozon në mënyrë të arsyetuar Komisionerit për të vendosur refuzimin për nisjen e hetimit administrativ” dhe të zëvendësohet me shprehjen “Komisioneri vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ.”

Kush është dakord, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Zbardhi materialin audio
Jonida SALIHARI

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Në pikën 3 propozohet të hiqet shprehja “Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së i propozon në mënyrë të arsyetuar Komisionerit fillim e hetimit administrativ” dhe të zëvendësohet me shprehjen “Komisioneri merr vendim për fillimin e hetimit administrativ”.

Kush është dakord, ju lutem?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Do të kërkoja dhe një votim në tërësi për Nenin 8 pasi ka tre ndërhyrje, kolegë. Neni 8 me të tre propozimet e votuara tashmë.

Kush është dakord në tërësi me Nenin 8?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet në tërësi projektakti!

Dakord kalojmë tek Neni 9.

Neni 9 “Mjetet e kërkimit të provës”:

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me denoncimin Administrata e KQZ-së mund:
 - a. Të mbledh deklaratat nga pala, palët dhe dëshmitarët.
 - b. Të marr dokumente dhe akte të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike.
 - c. Të vizitoj apo kontrolloj vende dhe objekte të përfshira.
2. Dispozitat e parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mbajtjet e provave.”

Zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative prej Administratës të KQZ-së

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

3. Faktet e njohura për KQZ-në, faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezantuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejme.

Një pyetje për strukturë juridike. Në pikën 2 “Mjetet e provave, mjetet e kërkimit të provës..”. Tek pika 2 e Nenit 9 kisha unë një pyetje, nuk isha unë e qartë.

(ndërhyrja nuk dëgjohet)

Atëherë, nuk po e vendosim si propozim, thjesht po e konsiderojmë një korrigjim, “Mjetet e kërkimit”

(ndërhyrja nuk dëgjohet)

Kemi ndonjë propozim për Nenin 9?

Këtë nuk po e konsideroj.. po zoti Çakaj. Po zonja Bushati.


Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Atëherë, unë propozoj.. meqenëse mu bë vërejtje e vazhdueshme për komente, propozoj:

“Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me denoncimin Administrata e KQZ-së nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, ku ftohen dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore mund..” etj..

Znj. I. Nano: Të lutem, “..nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së..” pastaj ku?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: “..ku edhe ftohen përfaqësues të subjekteve zgjedhore..” pra, “gjatë mbledhjes ku ftohen dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore mund..” edhe pastaj siç është.

Znj. I. Nano: Atëherë, një propozim kemi të znj. Bushati në pikën 1 të Nenit 9 “Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me denoncimin Administrata e KQZ-së nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

të KQZ-së ku edhe ftohen përfaqësues të subjekteve zgjedhore mund.." dhe vijon fjalia.

(ndërhyrja nuk dëgjohet)

Z. M. Çakaj: Po.

Znj. I. Nano: Ndërkohë, po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë, unë propozoj që në pikën 2 pas fjalës "dispozitat e parashikuara.." të shtohet "në Kodin e Procedurës Administrative.." dhe vazhdon fjalia "..dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.". Pra, në pikën 2 të shtohet pas "dispozitave e parashikuara .." ..

Znj. I. Nano: "..dispozitat e parashikuara në Kodin.." pra, të vendosim referencën në Kodin e Procedurave Administrative. Dakord, kemi propozim tjetër?

Mirë, ju ftoj së pari të votojmë propozimin e znj. Bushati. Po e lexoj sipas propozimit:

"Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me denoncimin Administrata e KQZ-së nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së ku edhe ftohen përfaqësues të subjekteve zgjedhore mund.."

Kush është dakord, ju lutem me propozimin e znj. Bushati?

Pro: S'ka

Kundra: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Me 5 vota kundër nuk miratohet!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Votojmë propozimin e z. Çakaj për të shtuar referencën “..në Kodin e Procedurave Administrative.”. Pra, “..dispozitat parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.” në pikën 2 të Nenit 9.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Këtë pjesën “mjeteve kërkimit të provave” nuk e vendosa si..

Z. M. Çakaj: Nuk është propozim.

Znj. I. Nano Po znj. Koja, ju lutem.

Znj. M. Koja: Vetëm për sqarim është referuara saktësisht siç përcakton Neni 80 i Kodit të Procedurave Administrative.

Z. M. Çakaj: Kjo me siguri.. (shkëputet)

Znj. M. Koja: Mund të ketë një lapsus patjetër, por është referua saktësisht.

Znj. I. Nano: Faleminderit znj. Koja!

Atëherë, kemi një të votuar kundër, një propozim të votuar pro.

Votojmë ne tërësi Nenin 9.


Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet Neni 9! Miratohet Neni 9 me të vetminë ndryshim të miratuar “Kodin e Procedurave Administrative” në pikën 2.

*Zbardhi materialin audio
Jónida SALHLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Atëherë, vijnë tek Neni 10 “Metodat për paraqitjen e informacionit dhe provave”:

1. Administrata e KQZ-së bashkëpunon me denoncuesin në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes.
2. Komisioneri njofton me shkrim subjektin që i nënshtrohet hetimit administrative dhe i kërkon të paraqes informacion, të dhëna ose prova brenda 10 ditësh nga marrja e kërkesës.
3. Në qoftë se subjekti nuk përgjigjet Komisioneri mund të bëj një njoftim të ri ose kur e kërkon interesi publik vendos për t’i kërkuar vetë provat dhe faktet me qëllim dhënien e një vendimi përfundimtar nga Komisioni.

Po. Unë kam personalisht një propozim duke qenë që më herët dhe rastet kur parashikohej në projektakt detyra apo përgjegjësit të Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve apo Administratës në tërësi ne vendosem që këtë përgjegjësi t’ia kalonim Komisionerit. Kështu që, unë do të propozoja vetëm heqjen e fjalës “Administrata” dhe duke lënë “KQZ” për të nënkuptuar KQZ-në si një institucion të tërë ku përfshihen disa organe, me të gjithë Administratën. Ky është propozimi im.

Ka propozim tjetër? Po znj. Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Meqenëse ne në Nenet pararendëse i çelëm siparin edhe anonimatit. I cili është normal në kushtet kur pretendohet apo mund të vijë edhe nga Administrata atëherë, mendoj që është e nevojshme që të shtohet në vijim të pikës 1, ta lidhim me lidhës “dhe” pas fjalës “çështjes”. “..dhe ruan me përgjegjësi të plot anonimatit e tij.”. pra, “KQZ bashkëpunon me denoncuesin në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe ruan me përgjegjësi të plot anonimatit e tij.”.

Në pikën 2 pas fjalës “dhjetë” ndoshta Administrata e ka harruar të përcaktoj “..ditëve nga marrja e kërkesës.”.

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021**

Znj. I. Nano: “10 ditëve” po, nuk e di në cilin variant.. “10 ditësh” është. Gramatikisht e korrigjojme.

Znj. H. Vukaj: Dakord. Propozimin e pikës 1 kisha, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zoti Çakaj kishit ju diçka?

Z. M. Çakaj: Jo, dakord jam.

Znj. I. Nano: Atëherë kemi dy propozime një për të hequr fjalën “administrata” nga pika 1 dhe 2 për të shtuar në fund të pikës 2 pra, në vijim të fjalisë “..dhe ruan me përgjegjësi të plot anonimati.”.

1. Votojmë ju lutem propozimin e parë heqjen e togfjalëshit “administrata e..” edhe kalimin në rasën emërore “KQZ-ja”.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

2. Propozimi i znj. Vukaj për të shtuar “..dhe ruan me përgjegjësi të plot anonimati.”.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!


Atëherë, Neni 10 pësoj 2 ndryshime madje pika 1 e Nenit 10.

E miratojmë në tërësi ju lutem Nenin 10.

Kush është dakord në tërësi me Nenin 10?

Zbardhja materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet në tërësi Neni 10!

Kalojmë tek Neni 11 "Sigurimi i provës":

1. Në rastet kur mendohet se një provë nga e cila varet zgjidhja e çështjes ose që ndikon në sqarimin e saj ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kryesisht apo me kërkesën të denoncuesit mund të vendos marrjen më parë të kësaj prove për aq sa është kompetencë e tij sigurimi i provës.
2. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të hetimit administrative. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së mund të vendos sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës të hetimit administrativ.

Kemi ndonjë koment/propozim? Zoti Çela.

Z. A. Çela: Faleminderit e Nderuar! Unë propozoj për të njëjtin fakt të përgjegjësisë siç tha edhe kolegja Vukaj që "Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së" të zëvendësohet me "Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve".

Znj. I. Nano: Në fakt kemi dhe në pikën 1 dhe në pikën 2.

Z. A. Çela: Po, në të dyja pikat.


Z. M. Çakaj: Po.

Znj. I. Nano: Pra, :

1. "Komisioneri kryesisht apo me kërkesën të denoncuesit mund të vendos marrjen më parë të kësaj prove.." në pikën 1 të Nenit 11.

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

2. Në pikën 2 “Komisioneri mund të vendos sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës të hetimit administrativ”. Kemi propozim tjetër?

Z. M. Çakaj: Jo, vetëm një diskutim të shkurtër. Pra, për koherencë të gjithë aktit duke qenë se së pari kemi vendosur Parimin e Përgjegjësisë. Së dyti qëllimi i këtij akti është ngritja e portalit dhe sigurisht krye gjithë hetimeve admirativë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Unë besoj dhe bie dakord edhe me propozimin e kolegut Çela për zëvendësimin e Sekretarit Përgjithshëm me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe më pas është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që ngarkon strukturën, drejtorin përkatëse apo një komision Ad-Hoc me qëllim shqyrtimin e denoncimit dhe e hetimit administrativ. Kështu që dakord jam me propozimin.

Znj. I. Nano: Faleminderit!

Atëherë, votojmë propozimin e zotit Çela. Në pikën 1 togfjalëshi “Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së” zëvendësohet me “Komisioneri”.

Në pikën 2 “Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së” zëvendësohet me “Komisioneri”. I votojmë të dyja, sepse është i njëjti propozim në të dy pikat.

Kush është dakord, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka


Me 5 vota pro miratohet Neni 11!

Me 5 vota pro miratohet Neni 11 me ndryshimet e propozuara dhe të votuara.

Neni 12 “Eksperti në hetimin administrativ.”

1. Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve që kanë lidhje me objektin e hetimit administrativ kërkohen njohuri të posaçme Komisioneri mund të thërras ekspert të licensuar të fushës.
2. Eksperti është i detyruar të përmbush detyrat e ngarkuara nga Komisioneri.

*Zbardhje materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

3. Eksperti duhet të deklaroj paraprakisht ruajtjen e konfidencialitet dhe më pas ka të drejtë të njihet me materialet e çështjes. Të bëj pyetje, të jap shpjegime dhe të kërkoj të dhëna të tjera brenda kufijve të nevojshme për kryerjen e detyrës.
4. Eksperti jep mendimin me shkrim dhe ai duhet të jetë i arsyetuar.
5. Mendimi eksperti nuk është i detyrueshëm. Çdo vendim për të mos e marrë parasysh këtë opinion duhet të shpjegohet qartë në përfundimet e hetimit.

Çelimi diskutimin për Nenin 12. Kemi ndonjë propozim konkret, ju lutem?

Nëse nuk kemi ndonjë propozim konkret kalojmë ne votimin e Nenit 12.

Po zoti Çaka.

Z. D. Çaka: Atëherë, është besoj më shumë për të pasur një kronologji të të gjithë terminologjisë së përdorur. Tek pika 5 kur themi në fund “..duhet të shpjegohet qartë në përfundim të hetimit.” të shtohet edhe fjala “të hetimit administrativ”. Mos të ngeli vetëm termi “hetim” megjithatë..

Znj. I. Nano: ..“hetimit administrativ” ndjesë. Votojmë propozimin e z. Çaka për të shtuar fjalën “administrativ” pas fjalës “hetimit” në pikën 5 të Nenit 12.

Kush është dakord, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 13 “Dyshimi për kryerjen e veprës penale.” :

1. Në rast se gjatë hetimit administrativ konstatohen veprime që dyshohet se përbejnë vepër penale pezullohet.. ndërpritet menjëherë shqyrtimi i mëtejshëm administrativ i çështje.
2. Komisioneri vendos nëse duhet të vijoj hetimi administrativ për rastin apo duhet të paraqes kallëzim penal në prokurori.

Unë kam një propozim ...

*Zbardhi materialin audio
Jónida SALILLARI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. I. Nano: Mesa duket dhe gjatë leximit e thashë, fjala “ndërpritet”, “shqyrtim i menjëhershëm”, “shqyrtim i mëtejshëm administrativ i çështjes” do të propozoja të zëvendësohej me fjalën “pezullohet” mendoj është në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe propozimi i rradhës ose vijimi, fjalia e dytë. Unë do të doja ta riformuloja pra, në mënyrë më të prerë të shkurtër. “Komisioneri në këtë rast paraqet kallzim penal në prokurori”. Kemi propozime të tjera? Pra dy propozimet e mija janë: Togëfjashëshi “ndërpritet menjëherë” të zëvendësohet me “pezullohet” dhe fjalia e dytë të riformulohet: “Komisioneri në këtë rast paraqet kallzim në prokurori”. Nëse s’kemi propozime të tjera të kalojmë në votim. Lidhur me propozimin e parë, “Ndërpritet menjëherë” të zëvendësohet me “pezullohet”. Kush është dakord? Atëherë ta lexoj nenin 13 në mënyrë integrale ku përfshihen dy propozimet. Në rast se gjatë hetimit administrativ konstatohen veprimet që dyshohet se përbëjnë veprë penale pezullohet shqyrtimi i mëtejshëm administrativ i çështjes. Komisioneri në këtë rast paraqet kallzim në prokurori.

Kush është dakord me propozimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet neni 13 i riformuluar!

Kalojmë në kreun 4 “Përfundimi i hetimit administrativ dhe marrja e vendimit”. Neni 14 “Përfundimi i hetimit administrativ”. Do t’ju lutesha administratës gjatë zbardhjes gabimet drejtshkrimore, të redaktojë dhe njëherë aktin. Atëherë,

1)Me përfundimin e kqyrjes së akteve, provave, grumbullimin e dokumentacionit dhe të dhënave, administrata përgatit relacionin për procedurën administrative të ndjekur;

2)Relacioni duhet të përmbajë në rend kronologjik procedurat e kryera, një përshkrim të gjetjes faktike, analizën ligjore të rastit pavarësisht nëse janë konstatuar ose jo shkeljet e ligjit apo akteve nënligjore. Nëse në fund të procesit

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

faktet dhe provat e mbledhura gjatë hetimit nuk provojnë dhe justifikojnë përfundimin se ka ndodhur shkelja e supozuar në denoncim ose e supozuar e denoncuar. Po e lexoj siç është në akt “Ky përfundim pasqyrohet në relacion nëse faktet dhe provat e mbledhura gjatë hetimit vërtetojnë se ka ndodhur shkelje. Relacioni përmban masat dhe sanksionet që propozohet te ndërmerren”.
Po, zonja Vukaj.

Zj. H. Vukaj: Meqënëse shkelja e supozuar është një term që nuk na qas ne me gjuhën juridike ose të aktit atëherë do të thoja se shkelja e supozuar të zëvendësohet me “denoncuar”. Pasi shkelja ka ardhur në institucion është denoncuar pavarësisht nëse do të ketë meritën për të vijuar procedimi apo jo. Është e denoncuar dhe propozoj ta implementojmë “të denoncuar”.

Znj. I. Nano: Pra, përfundimin se ka ndodhur shkelja e denoncuar dhe vijon fjalia ky përfundim pasqyrohet në relacion. Propozim tjetër kolegë?
Atëherë, votojmë propozimin për të zëvendësuar “shkelja e supozuar e denoncuar” me “shkelja e denoncuar”.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në nenin 15 “Procedura e miratimit të vendimit përfundimtar të Komisionerit”

- 1)Relacioni i hetimit administrativ i paraqitet pa vonesë Komisionerit;
- 2)Komisioneri si rregull brenda 5 ditëve nga marrja e tij njofton me shkrim subjektin për t’u njohur me gjetjet dhe i kërkon këtij të fundit të paraqesë prapësime në lidhje me të brenda 5 ditëve nga marrja e relacionit, provat e administruara si dhe me rezultatin e hetimit; Gramatikisht fjalia duhet riparë.

Zbardhi materialin audio

Silvi Sino



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

3)Komisioneri në rastet me impakt publik ose në ato raste kur e gjykon punën të arsyeshme organizon me prezencën e tij seancën dëgjimore publike brenda 5 ditësh nga marrja e relacionit me qëllim që subjekti i hetimit administrativ të paraqesë komentet, observacionet ose provat e tij;

4)Vendimi përfundimtar përmban:

a)Pjesën hyrëse që tregon:

“i” emrin e organit publik që nxjerr aktin;

“ii” Palët në proces;

“iii” Datën e miratimit;

“iiii” Bazën ligjore;

b)Palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ dhe kërkimet përkatëse;

c)Çdo provë të marrë në shqyrtim;

ç)Shpjegimin e rrethanave dhe fakteve që kanë rezultuar nga këto prova;

d)Analizën ligjore të çështjes;

dh)Dispozitivin që tregon pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur, kohën e hyrjes në fuqi të aktit, të drejtën e ankimit përfshi organin ku mund të paraqitet ankimi dhe afatin e ankimit;

5)Vendimi përfundimtar i njoftohet denoncuesit dhe subjektit që i është nënshtruar hetimit administrativ;

Atëherë kolegë kemi ndonjë diskutim, ju lutem? Po, zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë, më shumë për teknikën administrative në pikën 2 Komisioneri brenda 5 ditëve nga marrja jo e tij por e relacionit. Pra fjala “e tij” të zëvendësohet me termin konkret “relacioni” ku vijon fjalia dhe në pikën 3 “Komisioneri në rastet me një impakt publik” të zëvendësohet fjala “impakt” me fjalën “ndikim”. Këto dy propozime kisha.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Z. M. Çakaj: Në vazhden e propozimit që bëra më sipër tek pika 2 mbas fjalës “së hetimit” të plotësohet me fjalën “hetimit administrativ”. Ndërkohë tek pika 4 e aktit e këtij neni doja të propozoja që duke qenë se pika a/2 “palët në proces” dhe pika b “palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ dhe kërkimet përkatëse” është e njëjta gjë. Propozojë tek pika b e pikës 4 të hiqet togëfjalëshi “palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ” dhe të mbetet vetëm “kërkimet përkatëse”.

Znj. I. Nano: Atëhere, një koment nga zyra juridike. Ju lutem zonja Koja nëse është e mundur lidhur me shkronjën b të pikës 4.

Z. M. Koja: Atëherë, shprehem dakord për të hequr fjalën “pjesëmarrëse” por për të dhënë një shpjegim për ju arsyeja pse është vendosur “palët pjesëmarrëse”. Për të bërë diferencën nga “palët në shqyrtimin e procedurës administrative” dhe nga përvoja e deritanishme në KQZ ka pasur palë pjesëmarrëse por që nuk kanë qenë as palë ne proces as palë të treta në proces. Kjo ka qenë arsyeja pse ne kemi gjetur këtë togëfjalësh për t’ju referuar këtyre palëve por pa dyshim kërkimet përkatëse i përfshijnë dhe palët e tjera pjesëmarrëse. Kështu që shprehem dakord për ta shmangur këtë term për të mos krijuar konfondim me “palët në proces”, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Atëherë... Po zonja Bushati.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Tek pika 1 është lënë fjalia në vetë vetore “relacioni i hetimit administrativ i paraqitet pa vonesë Komisionerit”. Në linjën e gjithë aktit do të themi administrata apo kush do ta bëjë këtë.

Znj. I. Nano: Atëherë për shkak se ne e hoqëm Sekretarin e Përgjithshëm, apo administratën, sepse kjo do t’i mbetet vetë Komisionerit të caktojë një strukturë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. I. Nano: Sigurisht që do të përgatitet një relacion dhe ky relacion do t'i paraqitet Komisionerit, aktualisht sot që ne po diskutojmë aktin nuk dimë cila është kjo strukturë nuk mund të themi Sekretari i Përgjithshëm dhe nuk mund të themi të gjithë administrata dhe kur themi i paraqitet cilado strukturë që do të ngarkohet nesër nga Komisioneri ku t'i delegohen apo t'i ngarkohen detyrave përgjegjësi është ajo që do t'i paraqes relacionin.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Kur do të bëhet kjo? Kur do të vendoset kjo?


Znj. I. Nano: Cfarë pyetje keni kur do paraqitet relacioni apo kur do të vendoset struktura?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Kush do ta bëjë këtë, ky është akti ku duhet të përcaktohet se kush e bën këtë.

Znj. I. Nano: Atëherë propozimi juaj është administrata relacioni i hetimit administrativ i paraqitet pa vonesë Komisionerit nga administrata apo administrata, si do ta formuloni?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Jo unë e kam të vështirë ta formuloj sepse ju e hoqët Sekretarin e Përgjithshëm nga i gjithë akti. Po të ishte lënë Sekretari i Përgjithshëm është normal që të thuhej: Administrata e KQZ-së, përgatit relacionin dhe përmes Sekretarit të Përgjithshëm ia përcjell Komisionerit.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. I. Nano: E kemi një nen më sipër, në fakt tek neni 14 "Administrata përgatit relacionin, tani nëse në një akt normativ do të përcaktojmë dhe procedurat e brendshme kush i çon kujt, kur, çfarë është një gjë...

Propozim konkret zonja Bushati meqënëse është hera e parë, kuptoni dhe një herë pozicionin tuaj.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Administrata e KQZ-së i paraqet pa vonesë relacionin e hetimit administrativ paraqet pa vonesë relacionin e hetimit administrativ Komisionerit, nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.

Znj. I. Nano: Pra propozimi është administrata nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

Z. M. Çakaj: Me leje mund të bëj një sqarim të lutem?

Znj. I. Nano: Jo nuk duhet të bëjmë sqarime nga fillimi në fund, ju lutem zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Një sqarim se e kam përshtypjen ka të bëjë me efektin.

Znj. I. Nano: Tani Sekretari i Përgjithshëm u përjashtua nga të gjitha përgjegjësitë.

Z. M. Çakaj: Qëllimi i këtij akti zonja Bushati është të formalizohet të ngrihet një portal denoncimesh ku të gjithë palët, të cilat vlerësojnë se kanë akte prova apo indicie se po bëhet financim i paligjshëm apo kemi keqpërdorim burimeve publike për financimin e partive politike. Ata të kenë një portë një mundësi një

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

web ku të bëjnë denoncimet. E gjithë çështja ajo çfarë ne po normojmë normojmë gjithë parimet dhe mënyrën e funksionimit të pjesës pra trajtimin e këtij denoncimi. Në rastin konkret siç e sqarova dhe më parë në momentin që paraqitet një denoncim nga një person i interesuar Komisioneri mund t'ia ngarkojë këtë denoncim një strukture ose një strukture tjetër në varësi të natyrës së denoncimit dhe në varësi sesi ta çmojë ai të arsyeshme. Pra në rastin konkret unë personalisht nuk e gjej me vend vendosim këtu Sekretarin e Përgjithshëm apo të kondicionojmë Komisionerin, sepse mund të jetë dhe një strukturë hat hot që ka nevojë dhe ka njohuri e thelluara për gjykimin e këtij denoncimi. E rëndësishme është që së pari të vihet në lëvizje Komisioneri, së dyti të hetohet në përputhje me parimet e Kodit të Procedurës Administrative dhe së treti të kemi një vendimmarrje të drejtë dhe të aryetuar kjo është e rëndësishmja.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Mund të bëj një koment të shkurtër?


Znj. I. Nano: Koment jo zonja Bushati. Koment mbi komentet e anëtarit e Komisionit Rregullator.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Mirë një propozim atëherë.

Znj. I. Nano: Keni një propozim deri tani për riformulimin e pikës 1 të nenit 15, propozimi i dytë?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Atëherë unë nuk e imagjinoj që Komisioneri do të rrijë para kompjuterit duke parë portalin e denoncimeve dhe për këtë do ta bëjë dikush tjetër dhe në një nen më sipër në nenin 9 i kemi njohur administratës së KQZ-së të mbledhë deklaratat, dëshmitarë marr dokumente etj. Prandaj dhe nuk më duket dhe normale nga pikëpamja.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Znj. I. Nano: Ky është koment zonja Bushati nuk është propozim ju ndalova të bënit komente në rregullore në këtë fazë të shqyrtimit të aktit.

Të nderuar përfaqësues të subjekteve zgjedhore në këtë fazë të shqyrtimit të projektligjit kemi vajtur te neni 15 18 janë gjithsej vijojmë diskutojmë ende në parim. Në këtë fazë theksoj dhe një herë së pari në rradhë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore që bëjnë propozime konkrete për shtesa ndryshime. Më tej janë anëtarët e Komisionit Rregullator. Zonja Bushati ka bërë një propozim pika 1 e nenit 15 të riformulohet: Administrata e KQZ-së ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm i paraqet pa vonesë relacionin e hetimit administrativ Komisionerit. Jam korrekte me propozimin tuaj të parë?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Po.

Znj. I. Nano: Propozimi juaj i dytë?

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Propozimi i dytë është ky edhe në qoftë se nuk miratohet i pari, unë propozoj që fjalia të mos lihet në vetvetore sepse bie ndesh dhe me rregullat e teknikës legjislative. Në fund të ditës kemi të bëjmë me një procedurë dhe në procedurë përcaktohet dhe kush bën çfarë.

Znj. I. Nano: Pra propozimi juaj i dytë është që nëse nuk i propozohet i pari fjalia të mos mbetet vevtvetohen. Faleminderit, zonja Bushati!


Kemi propozime të tjera për këtë nen? I thamë në pikën 2 dhe 3, po i filloj propozimet jo sipas rradhës që janë bërë po sipas rradhës së pikave.

E para: Propozimi i zonjës Bushati për riformulimin e pikës 1 të nenit 15.

Kush është dakord?

Pro: **S'ka**

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Kundra: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Nuk miratohet propozimi i zonjës Bushati.

Do t'i lutesha administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që gjatë zbardhjes ta shihnin gjuhësisht pikën 1 të nenit 15.

Propozimi i zotit Çakaj në pikën 2 "brenda 5 ditësh nga marrja e relacionit" pra për t'u zevëndësuar "e tij" me "e relacionit"

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Propozimi i zotit Çaka në fund të fjalisë në pikën 2 si dhe me rezultatin e hetimit duke shtuar fjalën "administrativ".

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Propozimi gjithashtu i zotit Çakaj fjala "impakt" në pikën 3 të zevëndësohet me "ndikim".

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.


Propozimi i zotit Çaka i cili u sqarua edhe nga Drejtoria Juridike konsiston në heqjen e shprehjes "palët pjesmarrëse në shqyrtimin administrativ" dhe në pikën 4 shkronja "b" të nenit 15.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Me 5 vota pro miratohet.

Duke qenë në këtë vendim pati disa ndërhyrje, një pjesë u miratuan propozimet e zotit Çakaj dhe Çaka, propozimi i zonjës Bushati nuk u miratua ju ftoj të votojmë në tërësi nenin 15 me të gjitha ndryshimet e bëra.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kalojmë te kreu 5 "Dispozitat e fundit".

Neni 16 "Konfidencialiteti dhe ruajtja e anonimatit" Punonjësit e KQZ-së që kryejnë hetimin administrativ mbajnë administrojnë apo vihen në dijeni të fakteve të denoncuara dhe dokumentave të administruara në kuadër të tij kanë detyrimin sipas Kodit të Procedurave Administrative të zbatojnë parimet e konfidencialitetit dhe kur kërkohet nga denoncuesi të sigurojnë anonimatit e tij. Kolegë komente, propozime për shtesa ndryshime? Ju ftoj të votojmë nenin 16.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Neni 17 "Mbrotjtja e të dhënave personale"

1 Komisioneri në cilësinë e kontrolluesit sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dokumenton masat teknikoorganizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale kryhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr 9887 datë 10.03.2008 "për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Komente nga kolegët propozime për shtesa ndryshime? Nëse jo atëherë kalojmë në votimin e nenit 17.

Kush është dakord me propozimin e ardhur nga Komisioneri?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 17.

Neni 18 hyrja në fuqi ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Po zoti Çaka?

Z. D. Çaka: Faleminderit unë do të propozoja duke u bazuar tek vendimi që Komisioni Rregullator ka marrë për rregulloren e organizimit të funksionimit të punës së tij duke u bazuar dhe në Kodin Zgjedhor por dhe në praktikën që kemi krijuar do të propozoja që të shtohet një nen përpara nenit 18 që është hyrja në fuqi që është pjesa e ankimit duke shtuar që kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Zgj. I. Nano: Pra propozimi i zotit Çaka është që neni 18 “e drejta e ankimit” dhe neni 19 hyrja në fuqi. Sigurisht përmbajtjen e nenit të së drejtës së ankimit e kemi në të njëjtën përmbajtje me standart në secilën nga vendimet që ne kemi marrë.

Kush është dakord me propozimin e zoti Çaka për të shtuar nenin 18 “e drejta e ankimit”?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

Neni 19 është hyrja në fuqi votojmë dhe hyrjen në fuqi të vendimit gjithmonë sipas standartit, hyrja në fuqi menjëherë dhe publikim në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet. Atëherë kemi votuar në parim, kemi votuar nen për nen projektaktin "Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre". Duke qenë se i mbaruam këto dy procese ju ftoj të votojmë në tërësi projektaktin.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Mendova se mos formularin e kallëzimit do e trajtonim në fund për nga përmbajtja, në qoftë se ju e keni mbyllur nuk ka problem. Ka një aneks bashkangjitur vendimit.

Znj. I. Nano: Po ka një aneks bashkëlidhur i cili është parashikuar në nenin 6 dhe në nenin 6 nuk pati asnjë diskutim.

Po zoti Nuraj!

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Nuk kam ndonjë koment në lidhje me aktin pasi ishim dakord me të gjitha pikat e saj, duke qenë se është mbyllur ne e vlerësojmë këtë akt tepër të rëndësishëm dhe duke qenë se është kaq i rëndësishëm do të kërkonim dhe do të shpresonim që të mos të binte në nivelin kur edhe akti për veprimtaritë e ndaluara. Duke qenë se ky akt ndalon financimet si të drejtpërdrejta ashtu dhe të të thortat të cilat ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve do të kërkoja që të krijoj sa më shpejt dhe të vihej në funksionim portali pasi ne vlerësojmë se jemi akoma shumë vonë në lidhje me

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.09.03.2021*

miratimin e këtij akti, i cili duhet të ishte miratuar më përpara pasi vlerësojmë se duke qenë kaq me vonesë dhe duke vlerësuar që jemi dhe në fund dhe po kalojmë në fushatën zgjedhore, mendoj që me këtë vonesë ne i kemi ndërprerë rrugën ndërkohë denoncimeve që mund të ishin bërë për financime të cilat ne mendojmë se janë bërë ndërkohë me lidhje në fushatën zgjedhore. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Nuraj!

Do t'i jap përgjigje komentit tuaj por ta miratojmë në tërësi aktin. Ju ftoj të nderuar kolegë të miratojmë aktin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro sapo kemi miratuar vendimin "Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre". Sa më sipër ribashkohem komenteve të zotit Nuraj dhe të gjithë anëtarëve të Rregullatorit për rëndësinë e aktit dhe duke qenë që prezent në mbledhje kemi Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të sugjeroja që këtë shqetësim lidhur me vënien e portalit në punë në një kohë sa më të shpejtë do të thotë menjëherë pas miratimit të sotëm të këtij akti t'ia përcillni edhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Të nderuar kolegë e deklaroj mbledhjen të mbyllur Natën e mirë!

Vendimi nr.9

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*

